

## Aktivitet dy ditor në Paris, nën mikëpritjen e homologëve të Komisionit Rregullator për Energjinë të Francës – CRE

Në datat 31 janar dhe 1 shkurt 2023, Kryetari i ERE-s së bashku me Bordin e Komisionerëve dhe Sekretarin e Përgjithshëm, kanë qënë të ftuar nga CRE – Komisioni Rregullator për Energjinë i Francës, në një takim dypalësh me qëllim njohjen e misionit të CRE. Vizita e delegacionit të ERE-s u krye në vijim të takimit të zhvilluar nga ana e Rregullatorit Francez në Tiranë në vitin 2021 në kuadër të projektit të financuar nga ana e Agjencisë Franceze për Zhvillim, pjesë e reformës së sektorit energjistik.

Gjatë këtij aktiviteti pjesmarrësit u takuan me Znj. Wargon Presidente e CRE dhe Komisionerin Z. Ivan Faucheux, me të cilët u diskutua ndër të tjera mbi sektorin energjistik në të dy vendet, organizimin e Rregullatorëve, roli i ERE dhe CRE në organizmat ndërkombëtarë si MEDREG, ECRB, ERRA, CEER etj.

Në takim u diskutua dhe mbi krizën në sektorin e energjisë në Europë dhe si ajo ka afektuar sistemin energjistik European dhe rajonin tonë, si dhe sfidat në të ardhmen e Rregullatorëve në kuadër të tranzicionit energjetik.

Gjatë këtij aktiviteti u zhvillua dhe një takim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Francës RTE dhe u zhvillua dhe një vizitë në Qendrën Kombëtare Dispeçer të energjisë si dhe rolin e RTE në ENTSO-e dhe bashkëpunimin me OST në grupet Rajonale të punës.



Në përfundim të takimeve, u dakortësua për vijimin e bashkëpunimit midis të dy Rregullatorëve në fusha me interes të përbashkët për të dy palët si dhe vijimin e shkëmbimit të vizitave të stafeve të të dy Rregullatorëve.